

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Parandalohet tragjedia në Yzberisht, 23 të mitur shkojnë të rrihen me njëri-tjetrin, me vete kishin shkopa bejsbolli, blutë e 6-tës ndërhyrë menjëherë
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/parandalohet-tragjedia-ne-yzberisht-23-te-mitur-shkojne-t-e-rrihen-me--i402027
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:39:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5e334bbd1755f137dabb721359d939b3f94512d4ab434e4807f3a483d1f9de96
TEKSTI	36cbf0bb15cc7b3fee446f4334773167d7d8e62ae77f30771e7a72ed40dd9407
PAMJA	2ad267afd58d3955c3a0ed1c5c1419800fc8e256628589eef74c3c5643e88122

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	38f758f0592d727fba6d9e680d017151bf7ffad14e60dbdd2344eca1542f7677
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/38f758f0592d727fba6d9e680d017151bf7ffad14e60dbdd2344eca1542f7677

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

25 Shtator 2026, 13:35

Parandalohet tragjedia në Yzberisht, 23 të mitur shkojnë të rrihen me njëri-tjetrin, me vete kishin shkopa bejsbolli, blutë e 6-tës ndërhyjnë menjëherë

Shkruar nga Newsbomb



Foto ilustruese

Një ngjarje që mund të kishte përfunduar në një tragjedi është parandaluar në kohë nga Policia e Tiranës, pas një informacioni për një konflikt të planifikuar mes disa të miturve në zonën e Yzberishtit.

Bëhet fjalë për një grup të miturish, të moshave 13 deri në 17 vjeç, të cilët, sipas informacionit të siguruar nga uniformat blu, do të përfshiheshin në një konflikt në rrugën "Besim Alla". Në një kohë kur situata mund të përshkallëzohej me shpejtësi, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 kanë ndërhyrë në zonë, duke identifikuar disa prej të rinjve që, përveçse ishin mbledhur për t'u përplasur, kishin me vete edhe mjete të forta që mund të përdorreshin gjatë konfliktit.

Efektivët kanë sekuestruar dy shkopingj bejsbolli, ndërsa të miturit e konstatuar në vendngjarje janë shoqëruar në ambientet e Komisarariatit. Në vijim të veprimeve të policisë janë identifikuar edhe të miturit e tjerë që dyshohet se do të përfshiheshin në këtë sherr.

Në përfundim të veprimeve hetimore dhe procedurale, të kryera në praninë e prindërve dhe psikologut, materialet i janë referuar Prokurorisë, ndërsa për 23 të miturit, të moshave nga 13 vjeç deri në 17 vjeç ka nisur procedimi në gjendje të lirë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Anulohet tenderi 4.59 miliardë lekë për hemodializën në pesë qytete, Agjencia e Prokurimit Publik: Kishte mangësi dhe gabime në dokumente



Ekonomi

Rimbursimi i TVSH-së rënie vjetore me 33% në 8-mujor, 4.7 miliardë lekë më pak për bizneset

Zbulohet më shumë artikuj >

"Procedohen penalisht 23 shtetas të moshave 13-17 vjeç, që do të përfshiheshin në konflikt. Sekuestrohen 2 shkopinj bejsbolli. Menjëherë pas sigurimit të informacionit se dhjetëra të mitur do të konfliktoheshin në rrugën "Besim Alla", shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 kanë shkuar në zonën e sinjalizuar, për të parandaluar ngjarjen.

Efektivët kanë konstatuar disa të mitur të pajisur me shkopinj bejsbolli, për t'i përdorur gjatë konfliktit. Ata janë shoqëruar në ambientet e Komisarariatit dhe, në vijim, janë identifikuar dhe shoqëruar edhe të miturit e tjerë që do të përfshiheshin në këtë konflikt.

Në përfundim të veprimeve hetimore dhe procedurale, të kryera në prani të prindërve dhe psikologut, janë referuar materialet në Prokurori, ku ka nisur procedimi në gjendje të lirë për 23 të mitur. Gjithashtu, janë sekuestruar sendet e forta.", thuhet në njoftimin e Policisë.

Ngjarja vjen si një tjetër sinjal për rrezikun e konflikteve mes të rinjve, të cilat shpesh mund të nisin për motive të dobëta, por që në pak minuta mund të përshkallëzohen dhe të marrin përmasa shumë më të rënda. Për këtë arsye, Policia e Tiranës u bën thirrje prindërve, familjarëve, mësuesve dhe personave të afërt me të miturit që të tregohen të vëmendshëm ndaj çdo shenje konflikti apo përplasjeje mes bashkëmoshatarëve, përfshirë edhe ato që shfaqen në rrjetet sociale dhe hapësirat dixhitale.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 13:27

NUK KA MË SEKRETE! Sali Berisha nxjerr FOTON e drejtorit të Operacionales në SHISH dhe shkruan: Te lokali i tij në Bërzhitë takoheshin Gysi dhe Vlora



Aktualitet

Vlora Hyseni nën akuzë në Shqipëri, mediat në Rumani japin ALARMIN: Është stërvitur nga Gjenerali i Zi, Coldea ishte këshilltar i kryeministrit Rama dhe shef i spiunazhit rumun



Aktualitet

Dy 22 vjeçarët me parcelë kanabisi në Skrapar, i ruanin bimët me kallashnikov, sapo panë Policinë hodhën armën dhe u futën në pyll

🕒 E Premte 12:27



E Premte 12:03

VIDEO/ "Të q*fsha motrën", shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë



Aktualitet

"Pushtetet janë të ndara, por shteti është një", kryegjyqtari Sokol Sadushi kundër idesë së Edi Ramës për të shqyrtuar pagat: Kushtetuta nuk negociohet, Gjykata ka folur (FJALA E PLOTË)

E Premte 11:05



Aktualitet

Nën akuzë për 700 mijë euro të vjedhura, gjykata liron nga burgu dhe çon në shtëpi ish-drejtoreshën e Postës së Durrësit

E Premte 11:01



E Premte 10:30

Revista greke shkruan për historinë e Samir Manes: Miliarderi i vetëm i Shqipërisë që nuk u bë i pasur në paradhomat e elitës, por e filloi nga zero absolute (MARRËVESHJA PËR JUMBO)





Aktualitet

Nuk ranë dakord për çmimin e servisit të makinës, Policia zbardh plagosjen në Lezhë: Babë e bir i mbushën barkun me plumba mekanikut (EMRAT)

E Premte 10:11



Aktualitet

320 gramë kokainë në Lushnjë, arrestohen dy të rinjtë që e shisnin me doza në qytet (VIDEO)

E Premte 09:39



E Premte 08:21

Në kulmin e krizës së karburanteve, qeveria pritet të shtojë një taksë të re për naftën, efekti 40 milionë euro/vit



Aktualitet

Moti bën kthesën e papritur, Shërbimi Ushtarak: Sot priten reshje shiu me shtrëngata, breshër dhe dëborë

E Premte 07:58



Aktualitet

Altin Dumani dhe oficerët amerikanë të FBI udhëtuan dje drejt Kosovës, zbardhet çështja: Shkatërrohet tregu online "Rydox", shiteshin identitete të vjedhura (E PLOTË)

E Premte 07:30



🕒 E Enjte 23:36

DEL PËR HERË TË PARË: Në makinën e Ergys Agasit u gjet një pajisje me materiale sekrete vëzhgimi, janë përgjuar shtetarë të rëndësishëm (DEKLARATA)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.